



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1092/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Taulant Kelmendi, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1092/2021, i datës 08.11.2021 paraqitur nga Taulant Kelmendi, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal në Komunën e Pejës, me të cilin kerkon rinumrimin në vendvotimet 1707/04R, 1725C/03D

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Pejës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në Vendvotimet 1707/04R, 1725C/03D, në Komunën e Pejës.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet e vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga Taulant Kelmendi, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ),

për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, për ti rinumëruar fletëvotimet në Vendvotimim VV 1714C/01R

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1092/2021, (përmes postës të datës 04.11.2021), të paraqitur nga Taulant Kelmendi, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, me te cilën ndër të tjera pretendon se në vendvotimet 1707/04R, , 1725C/03D, VV 1714C/01R, ka pasur parregullsi në formularë, pasi që ka mospërputhje në mesë të formularëve të subjektit dhe kandidatëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura dhe sipas vlerësimit te te dhënave të kryera nga vet PZAP, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Taulant Kelmendi, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet e lartcekura. PZAP, pas shqyrtimit të pretendimeve në shkresat e lëndës gjeti se apeli është pjesërisht i bazuar. Në rastin konkret për vendvotimet 1707/04R, 1725C/03D, në Komunën e Pejës, paneli gjeti se ka mospërputhje të rezultatëve në Formularët e Regjistrimit të Kandidatëve, ashtu që në Formularin për Subjektin Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka më pak vota se sa për kandidatët e po të njejtit subjekt. Për vendvotimin 1707C/04R, për Subjektin Politik janë gjithsej 33 vota, ndërsa për kandidatet 36 vota. Në vendvotimin 1725C/03D, për Subjektin Politik janë gjithsej 23 vota, ndërsa për kandidatet 24 vota, për këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon

integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, sa i përketë vendvotimit VV 1714C/01R, sepse pas verifikimit të formularëve rezulton se nuk ka mospërputhje në mesë të votave të kandidatit dhe subjekti. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, pretendimet e saj mbeten vetëm në suaza të dyshimeve. Pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1092/2021 më datën 09.11.2021

Kryesues i Panelit

Burim Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.